

KONTRATË SHITJE-BLERJE AKSIONESH

E lidhur sot më datë 17.08.2023, (dymije e njëzet e tre), ndërmjet :

“**DH SOLAR PARK**” sh.p.k regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS M21809033PP me seli në Tiranë, në adresën: Rruga “Vaso Pasha”, Pallati 8, Kati 4 Ap. 10, me ortak Z. Hysen Ruka dhe Z. Dukagjin Lipa

Dhe

“**VEGA SOLAR**” sh.p.k regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS: L81913004H, me seli në Fier, në adresën: Lagjia “Sheq i Madh” Nr. Pasurie 155/48 ndërtese dy katëshe zona kadastrale 3981 , me ortak Z. Bruno Papaj dhe Z. Philipp Koronowski

Që këtu e më poshtë, mund të quhen

Të cilët, pas bisedimeve, sqarimeve dhe negociatave të zhvilluara për këtë qëllim, me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, me kërkuan redaktimin e kësaj Kontrate, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil dhe legjislacionin shqiptar në fuqi, me përmbajtjen që vijon:

NENI 1 TË DHËNA DHE DEKLARIME PARAPRAKE





- 1.1 Për sa më sipër dhe mbështetur në parimin e mirëbesimit reciprok në përmbushjen me korrektesë dhe veprimeve kontraktuale, Palët bien dakort si më poshtë:

NENI 2 OBJEKTI DHE QËLLIMI I KONTRATËS

- 2.1 Objekti i kësaj Kontrate është shitja në total e 2% (dy) të aksioneve, përkatesisht 1% (një) të aksioneve prej ortakut Z. Hysen Ruka dhe 1% (një) të aksioneve prej ortakut Z. Dukagjin Lipa.

NENI 3 SHPËRBLIMI

- 3.1 Shoqëria “Vega Solar” sh.p.k do ti paguaj si kundërshtëpërblim për aksionet e blera shumën totale prej 2,000 (dy mijë) lekë, përkatesisht vlerën 1,000 (një mijë) lekë për 1% (një) të aksioneve të ortakut Z. Hysen Ruka dhe vlerën 1,000 (një mijë) lekë për 1% (një) të aksioneve të ortakut Z. Dukagjin Lipa.

  1  

NENI 4
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

4.1 Shoqëria “VEGA SOLAR” sh.p.k deklaron se do të kryejë pagesën menjëhere me firmosjen e kësaj kontrate në llogaritë bankare të ortakëve të shoqërisë “DH SOLAR” sh.p.k, Z Hysen Ruka dhe Z.Dukagjin Lipa.

NENI 5
NJOFTIMET/KOMUNIKIME

5.1 Të gjitha njoftimet, kërkesat ose komunikimet e tjera që Palët i drejtojnë njëra tjetrës në lidhje me këtë kontratë, do të bëhen me shkrim dhe do të konsiderohen të kryera në mënyrë të rregullt kur u dërgohen Palëve në adresat vijuese:

- Për shoqërinë DH SOLAR PARK sh.p.k: Rruga “Vaso Pasha”, Pallati 8, Kati 4 ,Ap. 10, Tiranë.
- Për shoqërinë VEGA SOLAR sh.p.k: Lagjia “Sheq i Madh” ,Nr. Pasurie 155/48, Ndërtesë dy katëshe, Zona kadastrale 3981, Fier.

5.2 Të gjitha njoftimet, kërkesat ose komunikimet e tjera që do të dërgohen sipas paragrafit të mësipërm, do të konsiderohen rregullisht të marra nga pala përkatëse, në datën më të hershme midis: (i) datës së marrjes efektive nga Pala; (ii) datës së pranimi apo refuzimit të shënuar në njoftimin e marrjes nëse dërgohet me postë të regjistruar; ose (iii) brenda 48 orësh nga dorëzimi pranë një shërbimi të shpejtë postar të njohur ndërkombëtarisht.

5.3 Një njoftim për të cilin pala marrëse ka marrë dijeni, nuk do të jetë i vlefshëm nëse njoftimi është kryer në mënyra të ndryshme nga sa më sipër.

NENI 6
ZGJIDHJA E NJËANSHME E KONTRATËS

6.1 Kjo Kontratë do të konsiderohet e zgjidhur nëse brenda afatit 6 (gjashtë) mujor shoqëria VEGA SOLAR shpk, nuk do te kryeje pagesen.

2

NENI 7
INTERPRETIMI I KONTRATËS NË TËRËSI

- 7.1 Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së kontratës dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët të lidhin këtë kontratë.
- 7.2 Kjo kontratë zhvillimi e ruan fuqinë ligjore dhe i shtrin efektet ligjore edhe mbi trashëgimtarët e palevë kontaktuese sipas Legjislacionit Shqiptar në fuqi.

NENI 8
LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM DHE JURIDIKSIONI

- 8.1 Kjo Kontratë sipërmarrje redaktohet në përputhje me dispozitat e Kodit civil të Republikës së Shqipërisë, përkatësisht neni 659 e vijues, neni 757 e vijues etj. Për çështjet që nuk janë trajtuar konkretisht në këtë kontratë, do të zbatohen dispozitat përkatëse të Kodit Civil.
- 8.2 Palët në këtë kontratë, bien dakort se çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi dhe/ose zbatimi i kësaj kontrate të cilat nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim ndërmjet tyre, do t'i drejtohen Gjykatës së rrethit Gjyqësor Tiranë për zgjidhjen e tyre.
- 8.3 Kur midis palëve nuk arrihet zgjidhja e çështjes në mirëkuptim dhe kushtet shkelen nga njëra anë, kompetente për zgjidhjen e çështjes është Gjykata e Shkallës së Parë e juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

NENI 9
KONTRATA DHE NDRYSHIMET E SAJ

- 9.1 Kjo Kontratë zëvendëson të gjitha komunikimet dhe klauzolat e mëparshme kontraktore, me shkrim dhe me gojë.
- 9.2 Palët deklarojnë se kjo kontratë dhe deklaratimet në të janë të ligjshme dhe të vlefshme dhe çdo ndryshim i kësaj kontrate do të konsiderohet i vlefshëm vetëm nëse është nënshkruar rregullisht nga palët para noterit, dhe do t'i bashkëlidhet si pjesë përbërëse kësaj kontrate.
- 9.3 Kjo kontratë e ruan fuqinë e saj ligjore dhe i shtrin efektet e saj edhe mbi trashëgimtarët e Palës Pronare.
- 9.4 Asnjëra nga palët nuk ka të drejtë të bëjë ndryshime në mënyrë të njëanshme, pas nënshkrimit të saj. Për çdo problem që mund të lindë apo ndryshim i domosdoshëm i kontratës i diktuar nga kushtet e kontratës së vendit apo legjislacionit, palët do të informojnë njëra-tjetrën në adresat përkatëse me shkrim dhe vetëm pasi të kenë rënë dakort mund të realizojnë ndryshime në kontratë.

3



9.5 Kjo Kontrate është hartuar në 4 (katër) kopje origjinale në Shqip me të njëjtën vlerë.


DH SOLAR PARK sh.p.k

VEGA SOLAR sh.p.k

1. Ortaku Z. Hysen Ruka


1. Ortaku Z. Bruno Papaj


A blue circular stamp for DH SOLAR PARK SHPK is positioned to the right of the signature. The stamp contains the text: "DH SOLAR PARK SHPK", "M21809033P", and "Tirane - Albania".


A blue handwritten signature of Bruno Papaj is written over a horizontal line. To the right of the signature is a large, stylized blue scribble.

2. Ortaku Z. Dukagjin Lipa


2. Ortaku Z. Philipp Koronowski


A blue handwritten signature of Dukagjin Lipa is written over a horizontal line.


A blue handwritten signature of Philipp Koronowski is written over a horizontal line.




A blue handwritten signature of Philipp Koronowski is written over a horizontal line.


A blue handwritten signature is written over a horizontal line.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	M21809033P	
2. Data e Regjistrimit	09/06/2022	
3. Emri i Subjektit	DH SOLAR PARK SHPK	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	07/06/2022	
6. Kohëzgjatja	Nga: 07/06/2022	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Rruga Vaso Pasha, Njesia Bashkiake Nr.5, Ndertesa Nr.8, K 4, Ap 10, Tirane 1001	
8. Kapitali	100.000,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	2,00	
9. Objekti i aktivitetit	Ndertim, punime ndertimi, ndertim parqesh fotovoltaike, konsulence, mirembajtje panelesh diellore, shitje energjie	
10. Administratori/ët	Hysen Ruka	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 07/06/2023	Deri: 07/06/2028
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	HysenRuka	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 50.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	50,00	
*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)		
12.4 Komente (nëse ka)		
13. Ortakët	DukagjinLipa	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

13.1 Vlera e kapitalit	Para: 50.000,00	Natyre:
13.2 Numri i pjesëve	1,00	
13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	50,00	
<i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>		
13.4 Komente (nëse ka)		
14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		
15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: DH SOLAR PARK SHPK E-Mail: besart.ruka@bindi.al hysen.ruka@bindi.al Telefon: 0035542250715 Kutia Postare: 2962 2962	
16. Statusi:	Aktiv	

Datë: 15/08/2023

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)



Vulosur elektronikisht nga
Qendra Kombëtare e Biznesit
Date:2023/08/15 13:25:57 +02:00
M21809033p2023081513254764
2006

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra Kombëtare e Biznesit)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	L81913004H
2. Data e Regjistrimit	13/07/2018
3. Emri i Subjektit	Vega Solar
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	09/07/2018
6. Kohëzgjatja	Nga: 09/07/2018
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Fier Fier FIER Rruga L"Sheq i Madh", Nr. Pasurie 155/48, Ndërtesë dy katëshe, Zona kadastrale Nr. 3981.
8. Kapitali	2.280.800,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	2,00
9. Objekti i aktivitetit	Studimin, projektimin, konsulencen, mirëmbajtje , sipërmarrjen zbatuese dhe/ose jopublike të veprave me karakter shfrytëzimi dhe/ose administrimi publik dhe/ose privat si: ndërtimin e impianteve fotovoltaike, punime civile, punime elektrike etj. Tregtim me shumicë dhe pakice, import-eksport i materialeve, makinerive, pajisjeve dhe impianteve të ndryshme elektrike, impianteve/paneleve fotovoltaike, elektroshtëpiake, elektronike, sistemeve/impianeteve termike, të ftohjes e ngrohjes (kondicionimit), sisteme për mirë menaxhimin e energjisë, sisteme ndriçimi, të telekomunikacionit si dhe impianteve të tjera të ngjashme të destinuara për objekte civile dhe industriale, për sektore të ndryshme. Shitja me shumicë dhe pakicë brenda dhe jashtë vendit të materialeve të ndryshme elektrike dhe pajisjeve të tyre të të gjitha llojeve të materialeve të tjera industriale, si impiante ndriçimi, impiante të energjisë alternative, impiante të mbrojtjes nga ngarkesat atmosferike, impiante portash, barrierash dhe kontrollit te dedikuar, impiante kundra grabitjes, zjarrit,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	<p>përmbajtjeve dhe gazrave, impiante videovëzhgimi CCTV dhe speciale, impiante për transmetim të dhënash dhe telekomunikacioni etj. Projektimin, montimin dhe mirëmbajtjen e impianteve të prodhimit të energjisë elektrike, të linjave të TU / TM / TL të të gjitha kategorive dhe shpërndarjes së energjisë. Shërbime të ndryshme dhe punime shërbimesh në të gjitha fushat sipas shpërndarjes së energjisë. Ofrimi i konsulencës dhe asistencës teknike për projektimin, mirëmbajtjen, riparimin, prodhimin e pajisjeve elektrike, fotovoltaike, dhe të çdo materiali tjetër ndihmës të sistemit dhe rrjetit elektrik. Tregtim i energjisë nga burime të rinovueshme. Konsulencë dhe çdo aktivitet që lidhet me fushën e energjisë. Import eksport mallra e pajisje të teknologjise në fushën energjitikës etj, që do të përdoren në ndërtimin, mirëmbajtjen, dhe menaxhimin e centralit me impiante fotovoltaike e forma të tjera të prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme. Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, si dhe mund të kryejë çdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj. Tregtim të artikujve të ndryshëm industrial dhe ofrimi i shërbimeve me këto artikuj.</p>	
10. Administratori/ët	Skender Hoxhaj	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 27/05/2019	Deri: 27/05/2024
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	PhilippKoronowski	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 1.140.400,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	50,00	
*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)		
12.4 Komente (nëse ka)		
13. Ortakët	BrunoPapaj	
13.1 Vlera e kapitalit	Para: 1.140.400,00	Natyre:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

13.2 Numri i pjesëve	1,00
13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	50,00
<i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>	
13.4 Komente (nëse ka)	
14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Tirane Tirane Mëzez, Njësia Administrative Kashar në pasurinë nr. 186/17/1 në Zonën Kadastrale 2679, Tiranë
15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: Vega Solar E-Mail: info@vegasolar.al Telefon: 0694021115
16. Statusi:	Aktiv

Datë: 15/08/2023

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)



Vulosur elektronikisht nga
Qendra Kombëtare e Biznesit
Date: 2023/08/15 13:26:34 +02:00
L81913004H2023081513262494
2006

3

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra Kombëtare e Biznesit)